



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
Prokuroria Themelore Prishtinë / Osnovno Tužilaštvo Prishtina / Prishtina Basic
Prosecution
Autoriteti Kompetent

AD.nr.07/2024

Datë: 20.06.2024

Autoriteti Kompetent, duke vendosur lidhur me ankesën disiplinore të parashtruar përmes Këshillit Prokurorial të Kosovës, nga ana e palëve ankuese N. [REDACTED], S. [REDACTED] dhe L. [REDACTED], të gjithë nga fsh. [REDACTED], Komuna [REDACTED] kundër prokurorit A. [REDACTED] S. [REDACTED] Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, në bazë të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.5 dhe paragrafi 6, të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nxjerr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET ankesa kundër A. [REDACTED] S. [REDACTED], Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, pasi që duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 1, pika 1.3 dhe nenin 6, paragrafi 2, pika 2.1 dhe pika 2.12 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, veprimet e prokurorit nuk paraqesin shkelje disiplinore.

Arsyetim

Me datë 24.05.2024, Kryeprokurori, duke qenë në cilësinë e Autoritetit Kompetent, përmes Këshillit Prokurorial të Kosovës, nga palët ankuese N. [REDACTED] Sh. [REDACTED], S. [REDACTED] Sh. [REDACTED] dhe L. [REDACTED] Sh. [REDACTED] ka pranuar ankesë disiplinore, ndaj prokurorit A. [REDACTED] S. [REDACTED], i cili ka përfaqësuar në shqyrtim gjyqësor lëndën nën shenjë PP.II.nr. [REDACTED], ku palët ankuese në këtë çështje penale kanë pasur cilësinë e të dëmtuarve, me pretendimet se prokurori me mosveprimin e tij edhe pse ka qenë i obliguar të veproj, ka cenuar rëndë detyrën e tij zyrtare, duke i shkaktuar dëme të pariparueshme palëve të dëmtuara pa bazë ligjore dhe duke favorizuar të akuzuarin P. [REDACTED] R. [REDACTED] pretendime këto të cilat korrespondojnë me shkelje të nenit 6, paragrafi 1, pika 1.3 dhe nenit 6, paragrafi 2, pika 2.1 dhe pika 2.12 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti Kompetent, pas analizimit dhe trajtimit të detajuar të kësaj çështje, konsideron se pretendimet e ngritura ankimore nuk paraqesin bazë të mjaftueshme dhe të arsyeshme për të rekomanduar fillimin e procedurës disiplinore ndaj Prokurorit A. [REDACTED] S. [REDACTED]

Veprimet e Autoritetit Kompetent:

- Me datë 24.05.2024, Autoriteti Kompetent ka regjistruar ankesën disiplinore me numër AD.nr.07/2024.
- Me datë 27.05.2024, Autoriteti Kompetent ka njoftuar Kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes Letër Informimit, për pranimit e ankesës.

Të gjeturat e Autoritetit Kompetent:

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr. [REDAKTUAR] të datës 17.10.2019, ka akuzuar të pandehurin P [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] për vepër penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.2. nënpar.2.1. lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), e kryer në bashkëkryerje.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me datë 08.12.2023, në të cilin ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm A [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR], i autorizuari i palëve të dëmtuara N [REDAKTUAR] L [REDAKTUAR] dhe S [REDAKTUAR] Sh [REDAKTUAR] Avokat G [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] të dëmtuarit N [REDAKTUAR] L [REDAKTUAR] dhe S [REDAKTUAR] Sh [REDAKTUAR], mbrojtësi i të pandehurit Avokat A [REDAKTUAR] Gj [REDAKTUAR] dhe i pandehuri P [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] ndërsa nuk ishin të pranishëm e autorizuar e të dëmtuarës V [REDAKTUAR] T [REDAKTUAR] Avokate M [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] dhe e dëmtuara V [REDAKTUAR] T [REDAKTUAR]. Në bazë të nenit 323 par. 1. nen par 1.1 dhe nenit 324 par. 1 të KPP-së, i akuzuari P [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë. Pasi që i akuzuari, nuk e ka pranuar fajësinë, shqyrtimi ka vazhduar me fjalën hyrëse të palëve. Gjykata në bazë të nenit 343 par. 1 të KPP-së, pas marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe pas prezantimit të provave materiale, ka vazhduar me marrjen në pyetje të të akzuarit, i cili nuk e ka pranuar fajësinë. Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor gjyqësor, me datë 22.12.2023 ka marrë Aktgjykimin P.nr.425/2019, me të cilin e ka liruar nga aktakuza të akzuarin P [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] meqenëse nuk është provuar se i njëjti e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, ndërkaq të dëmtuarit V [REDAKTUAR] T [REDAKTUAR] si dhe S [REDAKTUAR] N [REDAKTUAR] dhe L [REDAKTUAR] Sh [REDAKTUAR] që të katër nga [REDAKTUAR] Komuna e [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar me këtë vepër penale janë udhëzuar në kontest civil.

Veprimet e ndërmarra pas hapjes së rastit

- Marrja e raportit nga ana e prokurorit A [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] lidhur me pretendimet ankimore.
- Shqyrtimi i shkresave të lëndës penale nën shenjë PP.II.nr. [REDAKTUAR]

Deklarimet e palëve ankuese

Me datë 21.05.2024, palët ankuese kanë dorëzuar në Këshillin Prokurorial të Kosovës ankesën disiplinore kundër prokurorit A [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] e cila pastaj është deleguar tek ne si Autoritet Kompetent me datë 24.05.2024. Në këtë ankesë disiplinore, palët ankuese pretendojnë se Prokurori A [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] me mosveprimet e tij, edhe pse ka qenë i obliguar të veproj, ka cenuar rëndë detyrën e tij zyrtare, duke i shkaktuar dëme të mëdha dhe të pariparueshme palëve të dëmtuara pa bazë ligjore, njëkohësisht ka favorizuar të akzuarin në rastin me numër të lëndës

në prokurori PP.II.nr. [REDAKTUAR] ashtu që pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc është udhëhequr procedura penale kundër të pandehurit P [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] KK.Glllogoc, për vepër penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par.2 nënpar.2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ku Gjykata Themelore me datë 22.12.2023 e ka liruar të pandehurin ndërsa sipas këshillës juridike palët e pakënaqura me këtë vendim kanë pasur të drejtë anekese në afat prej 30 ditësh, siç është e përcaktuar me ligj. Prokurori A [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] i cili ka përfaqësuar lëndën në shqyrtim kryesor kishte qëndruar pranë ndjekjes penale, kishte dhënë fjalën përfundimtare, kishte kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, mirëpo edhe përkundër kësaj i njëjti nuk kishte ushtruar anekesë pranë Gjykatës së Apelit, andaj në mungesë të anekesës nga prokurori i lëndës, aktgjykimi liruës kishte marrë formën e prerë dhe i pandehuri është liruar pa i shtjerrë prokurori të gjitha mundësitë ligjore për të mbrojtur aktakuzën, gjegjësisht të drejtat e palëve të dëmtuara, dhe nga ky lëshim i bërë nga prokurori A [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] në kundërshtim me detyrën e tij, i njëjti i kishte shkaktuar palëve të dëmtuara dëme të mëdha dhe të pariparueshme, ndërsa si pasojë e këtij mosveprimi nga ana e prokurorit ka përfutur i akuzuari duke u liruar nga akuza për vepër aq të rëndë dhe nduke përfutur shumë marramendëse krejt kjo në kundërshtim me ligjet e aplikueshme.

Deklarimet e Prokurorit A [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] sipas raportit të dorëzuar me datë 11.06.2024

Prokurori A [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] në raportin e tij të dhënë me shkrim me datë 11.06.2024, ndër të tjera ka deklaruar se: Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, më datë 19.08.2019 ka ngritur Aktakuzën PP/II.nr. [REDAKTUAR] kundër të pandehurit F [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] në drejtim të veprave penale Shantazhi nga neni 341 par. 1 të KRPK-së, Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së si dhe në bashkëkryerje me të pandehurit B [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] dhe S [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] në drejtim të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.2 pika 2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Ndërsa më datë 17.10.2019, është ngritur Aktakuzë edhe kundër të pandehurit P [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] në drejtim të veprës penale në bashkëkryerje me të pandehurit e lartcekur, Vjedhja e rëndë nga neni 327 par.2 pika 2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Në këtë çështje penale, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Glllogoc, Departamenti i Përgjithshëm, me Aktgjykimin P.nr.353/2019, të datës 16.05.2022, e ka shpallur fajtor të akuzuarin F [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] në drejtim të veprave penale Shantazhi nga neni 341 par. 1 të KRPK-së dhe Vjedhja e rëndë nga neni 327 par.2 pika 2.1 të KPRK-së. Për të akuzuarit B [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] dhe S [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] kjo gjykatë ka marrë Aktgjykim liruës, për veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par.2 pika 2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. GJYKATA E AELIT TË KOSOVËS-Departamenti i Përgjithshëm, me Aktgjykimin PAI.nr.1344/22, të datës 18.08.2023, e ka vërtetuar Aktgjykimin P.nr.353/2019, në pjesën liruës për të akuzuarit B [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] dhe S [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] lidhur me veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par.2 pika 2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa ka kthyer çështjen në rivendosje sa i përket të akuzuarit F [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] lidhur me veprat penale Shantazhi nga neni 341 par. 1 të KRPK-së, dhe veprës penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par.2 pika 2.1 të KPRK-së. Sa i përket, të akuzuarit P [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] Gjykata Themelore në Prishtinë- Dega në Glllogoc, Departamenti i Përgjithshëm, me Aktgjykimin P.nr.425/2019, të datës 25.12.2023, e ka liruar nga akuza për veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par.2 pika 2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Meqë, me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAI.nr.1344/22, ËSHTË VËRTETUAR Aktgjykimi liruës, sa i përket të akuzuarve B [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] dhe S [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] në

drejtim të veprës penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par.2 pika 2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e që nga përshkrimi faktik i aktakuzës rrjedh që të akuzuarit e lartcekur kanë kryer këtë veprë penale në bashkëkryerje edhe me të akuzuarin P. R. për të cilin po ashtu është marrë Aktgjykim lirues, Prokurori i shtetit ka vlerësuar se nuk kishte bazë për të paraqitur ankesë në këtë çështje penale, sa i përket të akuzuarit P. R. sepse një gjendje e tillë faktike veç se ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit. Për realizimin e kërkesës pasurore juridike, Gjykata në Aktgjykimin lirues P.nr.425/2019, të datës 25.12.2023, i ka udhëzuar palët e dëmtuara në kontest civil.

KONKLUDIM

Në cilësinë e Autoritetit Kompetent, konsiderojmë se në veprimet apo mosveprimet e prokurorit A. S. nuk gjejmë elemente të shkeljeve disiplinore të pretenduara nga palët ankuese, të cilat do të binin ndesh me Ligjin Nr.06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti Kompetent, pas pranimit të ankesës disiplinore nga ana e palëve ankuese, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas ankesës disiplinore, ka shqyrtuar shkresat e lëndës penale PP/II.nr. ka kërkuar raport me shkrim nga prokurori A. S. kundër të cilit është ushtruar ankesa disiplinore dhe ka vlerësuar pretendimet e të njëjtit dhe pas ndërmarrjes së këtyre veprimeve dhe analizimit të të gjeturave lidhur me këtë ankesë disiplinore, në kuptim të nenit 9, paragrafi 6, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka arritur në përfundim se ankesa disiplinore është e pabazuar dhe se prokurori A. S. nuk është përfshirë në veprime të cilat përbëjnë shkelje disiplinore.

Pretendimet e palëve ankuese se prokurori A. S. ka cenuar rëndë detyrën e tij zyrtare duke mos ndërmarrë veprime drejt ushtrimit të ankesës ndaj aktgjykimit lirues të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, përmes së cilit vendim ishte liruar i pandehuri P. R. duke i shkaktuar dëme të pariparueshme palëve të dëmtuara, këto pretendime nuk qëndrojnë, kjo për faktin se Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, në nenin 383 par.1 ka paraparë arsyet mbi të cilat mund të ushtrohet ankesë ndaj aktgjykimit, e që janë: 1.1. për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale; 1.2. për shkak të shkeljes së ligjit penal; 1.3. për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike; ose 1.4. për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale, konfiskimit, shpenzimeve të procedurës penale, kërkesave pasurore juridike, si dhe për shkak të vendimit mbi publikimin e aktgjykimit. Me të pranuar aktgjykimin P.nr.425/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, përmes së cilës është liruar nga aktakuza i akuzuari P. R. prokurori A. S. ka shqyrtuar aktgjykimin në fjalë dhe ka arritur në përfundim se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për ushtrimin e mjetit të rregullt juridik – ankesës. I akuzuari P. R. sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë ishte ngarkuar se në

bashkëkryerje me të akuzuarit B. R. dhe S. R. kishin kryer veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par.2, pika 2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Gjykata për të akuzuarit B. R. dhe S. R. kishte marrë aktgjykim lirues për veprën penale të lartpërmendur, dhe i cili aktgjykim ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit të Kosovës, Departamenti i Përgjithshëm, me Aktgjykimin PA1.nr.1344/22 të dt.18.08.2024, ndërkaq sa i përket të akuzuarit P. R. Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc me aktgjykimin P.nr.425/2019, të datës 25.12.2023 e ka liruar nga akuza për veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par.2, pika 2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Nga kjo rrjedhë se Gjykata e shkallës së dytë duke vendosur mbi ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë me të cilën kishte atakuar aktgjykimin lirues për të akuzuarit B. R. dhe S. R. në drejtim të veprës penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par.2 pika 2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ka vërtetuar këtë aktgjykim, e që nga përshkrimi faktik i aktakuzës rrjedhë se kjo vepër është kryer në bashkëkryerje me të akuzuarin P. R. për të cilin po ashtu është marrë aktgjykim lirues, prokurori A. S. me të drejtë ka vlerësuar se nuk ka bazë për të paraqitur ankesë në këtë çështje penale, sa i përket të akuzuarit P. R. sepse një gjendje e tillë faktike veçse ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë. Përveç tjerash, në nenin 380 par.1 të KPP-së, përcaktohet se: *"Kundër aktgjykimit të marrë nga gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues i gjykatës themelore, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit"*. Kjo dispozitë ligjore nënkupton se edhe prokurori si person i autorizuar për paraqitjen e ankesës **MUND TË PARAQESË ANKESË KUNDËR AKTGJYKIMIT**, e që e lë në diskrecionin e prokurorit nëse duhet paraqitur ankesë apo jo, respektivisht nëse janë plotësuar kushtet ligjore për paraqitjen e të njëjtës, e që prokurori A. S. pas vlerësimit të aktgjykimit ka ardhur në përfundim se një ankesë e tillë, për një gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë, do të ishte e pabazuar.

Ndërkaq pretendimi se mosparaqitja e ankesës nga prokurori A. S. ka shkaktuar dëm të pariparueshëm për të dëmtuarit, as ky pretendim nuk qëndron. Gjykata ka vërtetuar një gjendje faktike e cila ka dërguar deri në marrjen e një aktgjykimi lirues, në të njëjtin aktgjykim palët e dëmtuara janë udhëzuar që për realizimin e kërkesës pasurore – juridike të drejtohen në kontest civil, e drejtë kjo e palëve të dëmtuara që nuk mund të mohohet nga askush, sepse ka një procedurë tjetër përmes së cilës pala e dëmtuar ka të drejtë në parashtrimin e kërkesës për realizimin e kërkesës së tyre pasurore.

Ligji nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit në mënyrë taksative në nenin 8 par.1.1 përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e prokurorëve të cilat ndër të tjera përfshijnë: *ushtrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme dhe të sigurohen që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit*, andaj si Autoritet Kompetent vlerësojmë se veprimet e prokurorit A. S. janë konform autorizimeve ligjore dhe kushtetuese të Prokurorit të Shtetit si dhe vlerësojmë se në asnjë veprim të prokurorit në fjalë nuk janë gjetur elemente të shkeljeve disiplinore të pretenduara sipas ankesës disiplinore. Veprimet e prokurorit në fjalë kanë qenë në kuadër të ushtrimit të

funksioneve prokuroriale në përputhje me legjislacionin në fuqi, në kuptim të nenit 5, paragrafi 2 të Ligjit nr.08/L-167 për Prokurorin e Shtetit.

Përveç tjerash, në nenin 4, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-167 Për Prokurorin e Shtetit, përcaktohet qartë se "Prokurori i Shtetit dhe secili prokuror para ligjit siguron trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykime për të gjithë personat, pa asnjë diskriminim, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, legjislacionin në fuqi dhe konventa ndërkombëtare", e që në rastin konkret prokurori A [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] ka vepruar konform kësaj dispozite ligjore, duke trajtuar objektivisht këtë çështje penale juridike.

Për më tepër, Ligji Nr. 08/L-167 Për Prokurorin e Shtetit, neni 39, paragrafi 1 ka ofruar mbrojtje ligjore për këtë kategori, ashtu që *"Prokurorët gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni për veprimet e ndërmarra, vendimet e marra, apo mendimet e shprehura që janë brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre."*

Në kontekst të veprimeve të lartpërmendura, si Autoritet Kompetent vlerësojmë se nuk është provuar se Prokurori A [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] ka kryer shkelje disiplinore, shkelje këto të cilat do të binin ndesh me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe do të paraqisnin bazë të mjaftueshme për parashtrimin e kërkesës për fillimin e hetimeve disiplinore ndaj prokurorit në fjalë, në kuptim të nenit 12, paragrafi 2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Nga gjithë ajo çfarë u konstatua më lartë, kemi gjetur se nuk qëndrojnë pretendimet e palëve ankuese, ngase në asnjë rast NUK është vërtetuar se veprimet e prokurorit të lartcekur paraqesin shkelje disiplinore në bazë të nenit nenin 6, paragrafi 1, pika 1.3 dhe nenin 6, paragrafi 2, pika 2.1 dhe pika 2.12 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në kuptim të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ankesën disiplinore e **REFUZOJMË SI TË PABAZUAR.**

Me sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Autoriteti Kompetent - Kryeprokurori



Vendimi i dërgohet:

-Këshillit Prokurorial të Kosovës

-Arkivës